



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 32, datë 18.10.2023

PËR

MIRATIMIN E RISHIKIMIT TË KUSHTEVE GJATË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:  
“PARKU FOTOVOLTAIK BLUE 2” DHE NDËRTIMI I OBJEKTIT TË NËNSTACIONIT  
220/35 KV, ME VENDNDODHJE NË BASHKINË FIER

Në mbështetje të neneve 27, 28 të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të subjektit zhvillues shoqërisë “SPV Blue 2” sh.p.k., Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e rishikimit të kushteve gjatë ndërtimit për objektin: “Parku Fotovoltaik Blue 2” dhe ndërtimi i objektit të Nënstacionit 220/35 kV, me vendndodhje në Bashkinë Fier, me subjekt zhvillues shoqërinë “SPV Blue 2” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave vetëm për objektin “Parku Fotovoltaik Blue 2”, miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.22, datë 17.03.2021, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

BELINDA BALLUKU



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 13/03/2025